



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE “XHAFERR KONGOLI” ELBASAN

Date 06.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V PAJISJE PER POLIKLINIKEN E SPECIALITETEVE”
ndare ne lote:

Loti 1- “F.V pajisje mjekesore per Polikliniken e Specialiteteve”

Loti 2- “F.V pajisje mobilimi spitalor per Polikliniken e Specialiteteve”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39290000-1
33100000-1**

Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 24,998,754(njzet e kater milion e nenteqind e nentdhjete e tete mije e shtateqind e pesedhjete e kater)leke pa Tvsh

Per Lotin 1- “F.V pajisje mjekesore per Polikliniken e Specialiteteve” me fond limit 16,216,067 (gjashtembedhjete milion e dyqind e gjashtembedhjete mije e gjashtedhjete e shtate)leke pa Tvsh

Per Lotin 2- “F.V pajisje mobilimi spitalor per Polikliniken e Specialiteteve” me fond limit 8,782,687 (tete milion e shtateqind e tetedhjete e dy mije e gjashteqind e tetedhjete e shtate)leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

Per Lotin 1 F.V pajisje mjekesore per Polikliniken e Specialiteteve

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**;
- b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojcës 2**;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8**;
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiros minimale, llogaritjet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës**,*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës,

konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa 20%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP nëni 40 pika 4: "4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."

Eshtë kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratën mbi origjinën e mallit (firma prodhuese ,vendi I prodhimit ,model I ofruar)per pajisjet spitalore”.

Argumentimi: (Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.ne te cilen eshte percaktuar: Pika 8 ” *Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates* ” dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra të garancise se furnizimit të mallit objekt prokurimi).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën per periudhen e garancise se mallit , jo me pak se nje 1 vit garanci, duke perfshire blerjen dhe zevendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale, si dhe te gjitha sherbimet periodike parandaluese qe parashikon prodhuesi brenda periudhes se garancise. (kjo do te jete edhe kusht I kontrates ne rastin e shpalljes fitues)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kriteret në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontrates, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broschure me të dhënat teknike për pajisjen e ofruar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të hollësishme të kërkuara për këtë artikull. **Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet ,sipas modelit të deklaruar.** (Katalogu duhet të ngarkohet në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe

noterizuar në gjuhën shqipe ne pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kerkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:**

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose ;

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vetëdeklaratë, që pajisja e ofruar është e re, të një prodhimi origjinal

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere në përpyesetim dhe të lidhura ngushte me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontrates*, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : *Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kritere të vecanta në varësi të objektit që prokurohet ,të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontrates*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar ku në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofertim të pajisjes objekt i kësaj procedure .Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon,faks,e-mail,ëbsite nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: *Pika 5. ”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afatëve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që

parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit deri në ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në perputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **EN ISO 13485:2012/EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore ose ekuivalente, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit. ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë **Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.**

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë.

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit deri ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë*

ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.9 Ofertuesi duhet të paraqesi Certificate konformiteti sipas direktives CE ose FDA ose ekuivalent, për të gjithë artikujt e ofruar, të perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen e kërkuar në formë të tabelave, ku të plotësohet: Specifikimet teknike të ofruara, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/produktit, Numri i faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktin.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik"**, në të cilin është përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë I nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në consideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësitë kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: *Pika 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që I vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Autoritti Kontraktor nepermjet ofertes teknike, do te bej te mundur verifikimin me te sakte te artikullit te ofertuar, specifikimeve te tij, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) inxhinier te diplomuar ne nje nga profilet inxhinieri Elektronike / Elektrike / Mekatronike / IT / Biomedikal dhe te jete i trajnuar per instalim dhe servis te aparaturave biomjeksore. Per te punesuarin Inxhinier duhet të paraqesin diplomën, certifikatën e trajnimit, CV-në, kontratën individuale të punës. Ky punonjes do te jete personi pergjegjes per instalimin e aparaturave mjeksore dhe per trajnimin e stafit spitalor (mjeke, infermier, inxhinier) per perdorimin e sakte te aparaturave mjeksore.

Specifikimet Teknike Loti 1- “F.V pajisje mjekesore per Polikliniken e Specialiteteve”

1. Ekografi

- Pajisje stacionare echografie me ngjyra për ekzaminime të ndryshme : abdominale, kardiake, vaskulare, gjinekologjike, urologjike, pjesë të buta, muskuloskeletale etj.
- **Të ketë të paktën këto mënyra pune :**
 - B-mode
 - Pulsed ëave Doppler
 - High PRF pulsed ëave Doppler
 - Continuous ëave Doppler
 - Color compare mode
 - Dual and triple mode
 - 2D/Doppler, 2D/Doppler/Color
 - 2D optimization signal processing
 - Tissue harmonic imaging (THI)
 - Intelligent Doppler
 - Trapezoidal
 - Adaptive Doppler
- Të jetë e pajisur me ekran LED me rezolucion të lartë i vendosur në një krah të përkulshëm dhe të manovrueshëm në të gjitha drejtimet. Madhësia diagonale ekranit jo më e vogël se 19 inch
- Valëformues tërësisht digital me brez të gjerë
- Brezi dinamik 270dB ose më i madh
- Mbi 60.000 kanale të përpunuara në mënyrë digitale

- Të ketë 4 porta aktive për lidhjen e sondave
- Të ketë minimalisht 8 vatra fokale për secilën sondë
- Thellësia e imazhit deri në 30 cm
- Nuancat e grisë : 256 (8 bite) në B-Mode, Color dhe Doppler
- Të ketë 8 TGC (Time Gain Compensation)
- Tastierë alfanumerike
- Ndërfaqe e thjeshtë dhe intuitive grafike
- Të ketë altoparlantë stereo të inkuorporuar
- Kontrollat kryesore të jenë të aksesueshme shpejt dhe të grupuara në mënyrë logjike.
- Shpejtësia e përfutimit të kuadrove (frame rate) : Mbi 1000 kuadro për sekondë
- Shfaqje e imazhit lart/poshtë, majtas/djathtas
- Rishikimi me Cineloop :Përfutimi, ruajtja dhe shfaqja në kohë reale e mbi 1000 kuadrove.
- Zmadhimi rikonstruktuar në mënyrë digitale me të paktën 16 nivele
- Të ketë mundësi për upgrade të mëvonshme

- **Të ofrojë minimalisht matjet e mëposhtme**

- Distanca 2D
- Circumferenca ose sipërfaqja 2D nëpërmjet elipsit, trasesë së vazhdueshme, trase me caktim pikash.
- Distanca 2D lineare - e harkuar
- Vëllime 2D
- Matje elektronike me calliper të kontrolluara nga trackball
- Distanca manule në Doppler
- Trase manuale në Doppler
- Matje të kohës dhe të slope në Doppler
- Vlera të Doppler që përmbajnë treguesit PI, RI, S/D.
- Të ketë mundësi që të ndërtohen protokolle, matje dhe përlogaritje të krijuara nga vetë përdoruesi.
- Të shfaqe një faqe të dhënash/rezultatesh e cila të jetë plotësisht e editueshme.
- Të ketë raport të integruar të ekzaminimit të pacientit.

- **Të jetë e pajisur te pakten me paketa analizash për :**

Imazheri e përgjithshme

- Paketë e përgjithshme abdominale
- Paketë për pjesët e buta
- Paketë pediatrike
- Paketë muskuloskeletale

Vasculare

Analizë vasculare

- Vasculare abdominale.

- Cerebrovasculare
- Protokolle të vasculaturës transkraniale.
- Protokolle të ekstremiteteve majtas djathtas, lart poshtë.

Analiza OB/Gyn

- Rajoni i interesit (ROI) i harkuar
 - Profili biofizik
 - Indeksi i fluidit amniotik
 - Gestation i hershëm
 - Cranium fetal
 - Matje të shpejta Obstetrike
- MSD
- GSD

- Të ketë hard disk jo më të vogël se 500GB, Të ketë te pakten 3 porta USB, Të ketë DVD RË drive të inkorporuar, Të ketë dalje S-Video dhe HDMI
- Mundësi për të eksportuar në USB imazhe apo video në formatet BMP/AVI/MPEG
- Të ketë raportim të strukturuar DICOM për ekzaminime të ndryshme
- Të ketë menaxhim të strukturuar për të marrë, rregulluar, ruajtur, modifikuar imazhet dhe raportet
- **Të lëvrohet me aksesoret e mëposhtme**
 - Sondë konvekse me brez të gjerë frekuencash minimumi 2-5 MHz. Të ofrojë imazhe me rezolucion të lartë për aplikime abdominale dhe OB/Gyn.
 - Sondë lineare me brez të gjerë frekuencash minimumi 4-12 MHz. E përshtatshme për aplikime vasculare, pjesë të buta, muskuloskeletale.
 - Printer termik për imazhet mjeksore ,bardhë e zi

2. EKG Elektrocardiogramme

- EKG me regjistrim dhe perpunim 12 kanale me interpretim për një diagnostikim të hollesishëm të problemeve kardiake
- Me ekran minimalisht 7 inch. Të vizualizohen sinjalet EKG në 1,3,6, dhe 12 kanale. Me vizualizim të vazhdueshëm të Ritmit kardiak dhe printim i tij në çdo ekzaminim.
- Pajisjur me tastjere të integruar, me butona të dedikuara për funksione të shpejta.
- Me printer të integruar me rezolucion të lartë, të printojë në letër jo më të vogël se afërsisht 112mm dhe me dalje për lidhje të printerit të jashtëm
- Të ketë mundësi të printimit në formate të ndryshme, 1,3,6, ose 12 kanale, formati Standart dhe Cabrera. Me opsion të printimit të ritmit në menyren automatike.
- Të ketë disa menyra të kryerjes së ekzaminimit EKG, Manuale, Automatike. Me mundësi të printimit të analizës dhe interpretimit automatik.

- Te punoje i lidhur ne rrjetin elektrik 50Hz/220Vdhe me bateri per punim te pavarur, me mundesi te ruajtjes se ekzaminimeve ne database afersisht 800 deri ne 1000 ekzaminime.
- Me mundesi te vendosjes se parametrave te sinjalit EKG : Shpejtesi, Sensitivitet, Amplitude.
- Me filtra sinjali EKG dhe mundesi e aktivizimit/Caktivizimit te tyre : Filter 50 Hz per interferencat ne rrjet, Filtrat per interferencat muskulare 25Hz,35Hz,45Hz, Filtrat isoline 0.15 Hz, 0.45 Hz, 0.75 Hz, 1.5 Hz.
- Me dedektim te sinjalit EKG per cdo kanal ne menyre te pavarur (INOP dedection)
- Me mbrojtje ndaj pulsit te defibrilimit.
- Pajisur me daljet LAN dhe USB per opsion te lidhjes me PC ECG Management Softëare
- Pajisur me aksesoret standart
 - o Kabell pacienti EKG
 - o Elektroda shumeperdorimshe kraharori 6 cope
 - o Elektroda shumeperdorimshe ekstremitete 4 cope
 - o Xhel EKG
 - o Leter EKG
 - o Manual perdorimi

3. Spirometer

- Spirometer (desktop) per testimin e funksioneve pulmonare te frymemarrjes.
- Ekрани: ekran LCD me prekje 7 inç
- Ndërfaqje USB
- Sensori I rrjedhës: turbine dixhitale me dydrejtime
- Me turbine te riperdorshme
- Sensoriitemperaturës: gjysmëpërçues (0-45°C)
- Opsionale sensor oksimetrie
- Mënyra detektimi me infra të kuqe
- Parametrat e spirometrisë
- FVC, FEV1, FEV1/FVC%, FEV1/PEF, FEV1/VC, FEV1/FEF0.5, DTPEF, FEV FEV0.5/FVC, FEV0.75, FEV0.75/FVC, FEV2, FEV2/FVC, FEV3, FEV3/FVC, FEV1/FEV6, PEF, FEF25, FEF50, FEF2575, FEF7585, FET, Vext, ELA, FIVC, FIV1, PIF, FIV1/FIVC, FIF25, FIF75, R50, MVVcal, PIF, IRV, VC, IVC, IC, ERV, IRV, FEV1/VC, TV, VE, te, ti/t-tot, TV/ti, MVV
- Vëllimimaksimalimatjes: 10L
- Diapazoniirrrjedhjes: ±16L/s
- Saktësia e volumit: ±3% ose 50mL
- Saktësia e rrjedhjes: ±5% ose 200mL/s
- Rezistencadinamikepër 12L/s<0.5cmH2O
- Kapaciteti memories derinë 10,000 teste spirometrike.
- Te kete minimalisht disa aksesore , letra, klip hunde, filter.

4. Kabinet ORL

- Njësia ORL

- Me mbajtëse instrumentesh në krah të artikuluar
- Sirtarë të pajisur me guidë me mekanizema tip amortizatore
- Të jetë i lëvizshëm me rrota për lëvizje të lehtë
- Të jetë i pavarur nga uji sanitar, gazi i komprimuar ose kërkesa të tjera. Duhet vetëm furnizimi me energji elektrike që njësia të funksionojë.
- E përbërë nga sa vijon:
- Kërkesa të përgjithshme për njesinë
- Tavolinë punë prej druri të laminuar ose ekuivalent me sipërfaqe të lemuar për dezinfektim të lehtë kundër përhapjes së baktereve.
- Sirtarët janë si më poshtë:
- Të paktën një sirtar me ndarje UV (llambë germicide) për mbajtjen e instrumenteve të sterilizuara
- Të paktën një sirtar me lartësi 60 mm për përdorim të përgjithshëm
- Të paktën një sirtar për instrumentet e pista me konteniere plastike të lëvizshme
- Të paktën 3 mbajtëse nga të cilat 2 për endoskopët rigide të pastër ose të ndotur dhe 1 mbajtës për nazofaringoskop fleksibël
- Te jete I pajisur me mbajtës drite koke

- *Thithja (aspirimi)*

- Sistemi i thithjes i kompletuar me pompë me diafragme ose teknologji ekuivalente me kapacitet të paktën 50 litra/minutë
- Me tub njëpërdorimësh për kontroll më të mirë të higjienës
- Ndezja/fikja automatike kur doreza ngrihet
- Filtër antimikrobik
- Presioni i rregullueshëm nga 0 në 0,85 bar
- Hinkë shpëlarëse veshi në krah rrotullues të lidhur me vazën e mbetjeve likuide
- Vazo me kapacitet 2 litra

- *Larja e veshit*

- Shiringë larëse veshi me element ngrohjeje të kontrolluar nga mikroprocesori i vendosur në 37 gradë
- Te jete material inox i autoklavueshëm
- Të jetë i pavarur nga rrjeti i ujit sanitar

- *Sistemi i ajrit të kompresuar*

- Sistemi i ajrit të komprimuar i pajisur me:

- Grupi i dorezave të ajrit per perdorim te shpejte me një dorë dhe te jete i pershtatur per perdorim te spërkatësve të ndryshëm të barnave te vendosur ne mbajtesin e artikular te instrumenteve (shih përshkrimin e mësipërm);
- Cope 2, atomizues të drejtë me grykë fleksibël (kanula): 1 për spërkatje pluhuri dhe 1 për spërkatje të lëngshme; të autoklavueshme.
- Nr. 2 shishe ilaçesh në qelq të ndashme dhe të përshtatshme për të gjitha llojet e medikamenteve.
- Kompresor ajri i integruar pa vaj, me ndezje automatike pasi të ngrihet instrumenti
- Ajri i kompresuar Max 2,2 bar – plotësisht i rregullueshëm me anë të valvulës rregullatore
- Kontrolli dhe shfaqja e parametrave te sistemit të ajrit të kompresuar në ekranin me prekje
- Te furnizohet me “Polizter olives nozzles attachments” – 2 cope

- ***Ngrohëse pasqyre***
- Ngrohëse e shpejtë pasqyre për të trajtuar pacientët me instrumente të ngrohta, duke mos krijuar veshtiresi per pacientet ndaj instrumenteve të ftohta.
- Ngrohës i pozicionuar në mënyrë ergonomike

- ***Burim drite***
- Burim drite led me 1 kanal për kabllo fiber optike, me llambë LED affersisht 5.500°K (50.000 orë pune)
- Te jete i pajisur me kabllo percues drite dhe konektor. Gjatësia e kablos jo më pak se 1800 mm – diam. 3,5 mm

- ***Karrige pacientit ORL***
- Karrige e pacientit ORL e pajisur me nje kolone ngritese që operon lëvizjen LARTË/POSHTË për aktivitete bazë të ekzaminimit.
- Të pajiset me:
- Strukturë kompakte në metal e lyer me pluhura epokside e kompletuar me mbulesë në abs me rezistencë të lartë për bazen
- Mbështetja e këmbës dhe mbështetësja e shpines me levizje manuale nepermjet dorezave. Me sistem susatsh dhe pistonash me gaz
- Te mundesoje shtrirjen në pozicionin e shtratit
- Rrotullim prej 360° me levë bllokuese
- Pjesët e veshura të karriges do të përbëhen nga shkumë me densitet të lartë dhe të padeformueshme
- Mbështetësja anatomike e kokës e artikular me rregullim manual në drejtim vertikal dhe përpara.

- ***KARRIGE E MJEKUT***

- Karrige me unazë për mbështetëse këmbësh, strukturë çeliku, rrota rrotulluese 360 gradë,
- Lartësia e rregullueshme me susta gazi, rrotullim 180 gradë dhe mbështetëse shpine e rregullueshme në thellësi.
- E levizshme e montuar në 5 rrota. Sedilja dhe mbështetësja janë të konturuara për rehati shtesë dhe janë bërë nga shkumë me densitet të lartë dhe të mbuluara me material rezistent për pastrim të lehtë.

- ***AUTOKLAVË***

- Autoklavë me komandim elektronik, për sterilizimin e instrumentave ambulatory, e klasit B me dhomë sterilizimi të pakten 18 litra
- Me system të integruar të nxehjes dhe gjeneratorit të avullit dhe pompe vakumi
- Të sterilizojë material të mprehta dhe të buta, në temperaturat 120° C dhe 134°C.
- Me shfaqje në ekran të parametrave (temperature, kohe sterilizimi) dhe çelës komandimi
- Endertuar me material celik kundër ndryshkut
- Dimensioni minimal i dhomës afersisht : Ø 260 x 350 mm

- ***SISTEM VIDEO ENDOSKOPIE ME KAMERA CCD***

- Kamera duhet të jetë profesionale për Diagnostifikim, për marrjen e imazhit në video-endoskopi.
- Duhet të jetë i pajisur me kablo dhe të bëjë lidhje direkte me çdo PC ose Notebook me port USB.
- Kompleti i kamerës përbëhet nga:
 - Kamera CCD
 - Të paktën 700 x 550 piksele
 - Iris elektronike
- Përshtatës endoskopi për të bërë të mundur lidhjen e të gjithë endoskopëve të furnizuar siç kërkohet më tej:

- ***NASOFARINGOSKOPI***

- Nazofaringoskopi me fibra optike i përshtatshëm për endoskopinë diagnostike në fushën e ENT.
- Kjo pajisje duhet të jetë e destinuar për ekzaminimin dhe analizën e zgavrës së hundës dhe faringut.
- Karakteristikat teknike:
 - Shënim me diametër të jashtëm baraz ose më shumë se: 2,8 mm, për t'u përdorur edhe për pacientët pediatrikë
 - Gjatësia e punës jo më pak se : 310 mm
 - Këndi i shikimit, minimumi: 70°
 - Përkulje: lart/poshtë, minimumi 120°

- ***Sinuskopi***

- sinuskop rigid – diametër Ø 2,7 mm, drejtimi i pamjes. 30° / Gjatësia të paktën 170 mm, e autoklavueshme

- **ENDOSKOPI VESHI**
- ENDOSKOPI rigid i veshit – diametri Ø 2,7 mm / drejtimi i shikimit. 0°/ Gjatësia të paktën 50 mm, e autoklavueshme

- **LARINGOSKOPI**
- LARINGOSKOPI rigid – diemetër Ø 10 mm/ drejtim i pamjes. 70°/Gjatësia të paktën 190 mm, e autoklavueshme, ndriçim anësor

- **Sistemi i regjistrimit dhe dokumentimit të videove**
- Sistemi o të jetë i pajisur me softuer video regjistrues per regjistrimin e imazheve dhe regjistrimin audio/video. Softëare duhet te ete I afte dhe për të menaxhuar bazën e të dhënave të pacientit
- Duhet te lejoje në mënyrë të thjeshtë ruajtjen e imazheve dhe videove automatikisht në dosjen e pacientit, rishikimin dhe shkrimin e raporteve dhe printimin e tyre.
- E pajisur me një monitor me ekran me prekje minimale 24 inç të montuar në njësi
- Pajisur me njesine e PC-së minimalisht core i7 i pajisur me maus dhe tastierën ëireless ë dhe vendoset në krahun e artikulluar të integruar me mundesi dhe mekanizem per tu montur ne njesine ORL.
- Zgjidhja e duhur e montimit të sa më sipër në njësi.

Foto Ilustruese



5. Kabinet Okulistik

- Kabinet I kompletuar me pajisjet okulistike per realizimin e vizitave baze ambulatore si me poshte:

Kabineti duhet te jete e pajisur me pajisjet si meposhte:

- Unit Refraktometer

- Te jete nje njesi moderne oftalmologjike me dizajn praktik, modern dhe ergonomik.
- Tavolina duhet te jete per dy pajisje, te levizshme anash dhe qe te rrotullohet deri ne 90 grade.
- Te kete rregullim lartesis elektrike rreth 80—90 cm.
- Te jete e pajisur me bllokues sigurie magnetik.
- Te kete nje karrige ekzaminimi te pacientit me lartesi afersisht 50 cm.
- Te kete aftesine per te ngritur karrigen e ekzaminimit te pacientit: te pakten ± 20 cm.
- Karrigia te mund te rrotullohet afersisht 90 grade dhe pjeresi te pakten 30 grade.
- Te kete nje kolone projektori afersisht 170 cm.
- Te kete nje kontroll funksioni te integruar me tregues te drites.
- Te ofroje furnizim me energji me 6-pin te integruar ne tryeze per refraktometrin, slit lamp ose pajisje tjeter, si dhe butonat per rregullimin e drites.
- Te kete nje pozicion te pershtatshem alumini per instalimin e nje phorofter-i ose nje projektori grafik.
- Tabela duhet te kete dy priza 230V ne anen e saj per lidhjen e pajisjeve.
- Te kete nje drite leximi LED te bardhe 12V.
- Konsumi i energjise i njesise: jo me shume se 300VA.
- Furnizimi me energji i njesise te jete 230VAC $\pm 10\%$.

- Slit Lamp

- Mikroskop binokular i tipit Galilean.
- Te kete zmadhim me te pakten 5 hapa me perafersisht.: 6X, 10X, 16X, 25X, 40X, me doreze te rrotullueshme.
- Te jete me nderfaqe per lazer dhe tonometer aplanacioni.
- Okularet:
 - Zmadhimi: 12.5x
 - Kendi i shikimit: 13°
 - Distanca e rregullueshme ne diapazonin: 52 mm– 85 mm
- Fushe pamja 5.5 mm – 33 mm
- Rregullimi i dioptrise te pakten: -7D deri +7D
- Gjeresia e hapjes 0 - 14 mm e ndryshueshme ne menyre te vazhdueshme.
- Lartesia e hapjes 0 - 14 mm e ndryshueshme ne menyre te vazhdueshme.

- Kendi i hapjes: 0 - 180 i ndryshueshem ne menyre te vazhdueshme.
- Te kete te pakten filtrat:
 - Blu Kobalti
 - Gri (ND)
 - Pa te kuqe (Gjelber)
 - Absorbsioni i nxehtesise
- Burimi i ndricimit: me drite te ngrohte LED, me jetegjatesi jo me me pak se 45,000 ore pune.
- Kendi i animit te ndricimit te pakten: 5, 10, 15 dhe 20 grade.
- Kontrolli i ndricimit, i rregullueshem ne menyre te vazhdueshme.
- Levizja vertikale e mbeshteteses se mjekres te pakten 80 mm.
- Diapazoni i levizjeve:
 - Levizja anesore: jo me pak se 100mm
 - Levizja ne thellesi: jo me pak se 100mm
 - Levizja e larte: jo me pak se 30mm
 - Rregullimi i holle: jo me pak se 20mm
- I pajisur me tonometer aplanacioni me parametrat si meposhte:
- Te jete nje tonometer tip Goldmann.
- Diapazoni i matjes: 0 mmHg - 80 mmHg, me hap te pakten: 2mm.
- Saktesia: ± 0.5 mmHg.
- Diametri i zones pneumatike: jo me pak se 3 mm.
- Zona e aplanacionit: jo me pak se 7 mm².
- Ndarja e linjes se transportit te sondes: te pakten 43°.
- Te furnizohet me aksesoret e meposhtem:
 - Shiriti i kalibrimit
 - Prizmi
 - Baza e montimit
 - Blloku i bazes se tonometrit

- **Auto Ref-Keratometer**

- Pajisja duhet te jete refraktometer/keratometer automatik i syrit duke perdorur teknologjine e grupit te mikrolensave Shack – Hartmann me 108 pika matjeje efektive.
- Pajisja duhet te jete ne gjendje te mate madhesine e bebes dhe distancen nga e bardha ne te bardhe.
- Ekрани i pajisjes duhet te jete i rregullueshem ne diapazonin e kendit 90 grade, duke siguruar nje kend te rehatshem shikimi nga operatori si ne kembe ashtu edhe ulur.
- Te jete me ekran TFT LCD me ngjyra, jo me pak se 8”.
- Pajisja duhet te kete nje mbeshtetese mjekre te motorizuar.
- Pajisja te kete funksion 2D automatik te modalitetit te levizjes lart/poshte.

- Pajisja te ofroje mundesine per te komunikojte me nje phorofter.
- Pajisja te ofroje funksionet meposhtme te matjeve:
 - K/R: Matja e refraksionit dhe keratometrise
 - REF: Matja e perthyerjes
 - KER: Matja me keratometri
 - Matja e modalitetit IOL
 - ZMAP
- Pajisja duhet te siguroje matje refraktive me karakteristikat e meposhtme:
 - Distanca e verteksit: 0,0 mm, 12,0 mm, 13,5 mm, 15,0 mm
 - Sfera, te pakten: -20,00 ~ +20,00D (me hap 0,12/0,25D) (VD=12mm)
 - Cilindri, te pakten: 0,00 ~ ± 10,00D (me hap 0,12/0,25D)
 - Boshti, te pakten: 0° ~ 180° (hap 1°)
 - Distanca pupilare, te pakten: 10 ~ 85 mm
 - Diametri minimal i bebes: 2.0mm
- Pajisja duhet te siguroje matje keratometrike me karakteristikat e meposhtme:
 - Rrezja e lakimit, te pakten: 6,5 ~ 9,5 mm (me hap 0,01 mm)
 - Fuqia refraktive, te pakten: 35.5D ~ 52.0D (me hap 0.12 / 0.25D)
 - Fuqia e lakimit, te pakten: 0,00 ~ 15,00D (me hap 0,12 / 0,25D)
 - Boshti: 0° ~ 180° (me hap 1°)
- Te kete nje dalje te dhenash me porte RS232 dhe nje dalje video.
- Te kete printer termik te integruar, me prerje automatike letre.
- Furnizimi me energji: AC100 ~ 240V, 50/60 Hz.

- **Komplet lentesh prove me valixhe dhe skelet prove**

- Set of trial lenses, 266 pieces.
- Set lentesh prove, te pakten 260 cope.
- Te kete lente sferike dhe cilindrike, pozitive dhe negative.
- Te kete lente speciale per distancen e bebes, verberine e rreme dhe ndjeshmerine ndaj ekzaminimeve te ngjyrave.
- Lente me konture metalike.
- Te shoqerohen me valixhe mbajttese.
- Korniza e lenteve prove e bere me çelik inox.
- Distanca e bebes e rregullueshme ne diapazonin: 48 – 80 mm.

- **Projektor grafik**

- Projektor modern grafiku per vleresimin e qartesis vizuale.
- Te perfshije te pakten 33 tabela standarde nderkombetare
- Shpejtesia e perzgjedhjes se grafikut 0,3s
- Maskim: 1 e hapur, 3 vija horizontale, 5 vija vertikale, 15 shkronja te vetme

- Filtri i kuq/gjelber
- Distanca e projektimit: 2m – 7m
- Madhesia e projekcionit ne 5m: 330x225mm
- Burim drite llambe LED 5Volt, 5Watt
- Konsumi i energjise: 50VA
- Burimi i energjise: AC100-240V 50/60Hz

- **Komplet ne valixhe Retinoskop / Oftalmoskop me doreze te rikarikueshme**

- Pajisja te jete nje komplet me nje koke oftalmoskopi, nje koke retinoskopi dhe nje doreze per te fuqizuar te dyja kokat.
- Koka e oftalmoskopit duhet te kete:
 - Rregullimi i dioptrise nga -35 ne +40 D ne 27 hapa
 - Gjashte diafragma: çarje, yll fiksues, kobalt blut, rreth i madh, rreth i vogel, gjysmerreth.
 - Filtri infra te kuqe
 - Sistemi optik asferik
 - Kornize prej alumini te derdhur
 - Konstruksion rezistent ndaj pluhurit
 - Llambe halogjene 2.5 V
- Koka e retinoskopit duhet te kete:
 - Filter polarizues per te eliminuar reflektimet
 - Optike shume e veshur
 - Konstruksion rezistent ndaj pluhurit
 - Llambe halogjene 2.5 V
- Doreza e ushqimit duhet te kete:
 - Ene per kokat e oftalmoskopit dhe retinoskopit
 - Kontrollues i ndriçimit me ndezje/fikje
 - Butoni i zhbllokimit
 - Furnizimi me energji 2.5 V
 - Funksionimi me dy bateri te tipit C/LR14

- **Kamera Fundus Dixhitale**

- Kamera fundus dixhitale automatike, jo-midriatikem, me teknologji dhe dizajn modern, per vezhgimin e retines me nje sistem me kamera te dyfishte.
- Te mund te marre automatikisht fotografi me nje klikim te vetem.
- Rregullimi automatik i mbeshteteses se mjekres, kerkimi dhe shtrirja e bebes.
- Fokusimi dhe ekspozimi automatik i definicionit te te dy syve, me nje buton te vetem.
- Te mund te punohet ne modalitetin manual me shtrirjen dhe fokusimin manual te bebeve.
- Te kete rregullim automatik dhe manual te blicit dhe ndricimit te imazhit te fundusit perpara se te merret fotografia.

- Te kete aftesine per te permiresuar konfigurimin ne Red Free, FFA (Fluorescein Fundus Angiography) ose FAF (Fundus Auto fluorescence)
- Te kete funksionin e mozaikut per gjenerimin e imazhit te fundusit deri ne fushepamje 135° nga 9 imazhe me gjeresi te fushes 50°.
- Te kete pika fiksimi te rregullueshme.
- Te suportoje lidhjet DICOM/PACS dhe sistemet AI.
- Te mundesoje USB per zgjerimin e hapësirës ruajtjese dhe transmetimin ne distance nepermjet sistemit FTP.
- Te kete software multifunksional me funksion te perpunimit te imazhit, pervetesimin e zones se lezionit dhe Cup Disc ratio.
- Software te mundesoje ndryshimin e games, kontrastit, ndricimit dhe ngjyres.
- Te kete karakterisikat e meposhtme:
 - Fusha e shikimit: 50°
 - Perfitimi: Jo-midriatik / midriatik
 - Distanca e punes: 35 mm
 - Diametri minimal i madhesise se bebes: 3.3 mm
 - Fotografia: Kamera SLR
 - Rezolucioni: te pakten 24 megapiksel
 - Kompensimi i dioptrise: $\pm 25D$
 - Fiksim: Fiksim i brendshem / Fiksim i jashtem
 - Drita ndihmese e fokusimit automatik: LED infra te kuqe
 - Te suportoje DICOM 3.0
 - Te kete porte personalizimi per AI
- Furnizimi me energji elektrike: 100-240 V, 50/60 Hz

- **Lente 90D**

- Per ekzaminime te pergjithshme dhe pamje retinale
- Te jene ne gjendje te kalojne neper pupila te vogla
- Te jene ne gjendje te kryejne ekzaminime retinale, kur kjo eshte e pa dilatuar.
- Fushepamja perafersisht 75° / 88°
- Zmadhim i pamjes perafersisht 0.7x
- Distanca e punes perafersisht 7mm



Foto Ilustruese

6. Elektroencefalogramme

Sistem EEG stacionar i perbera nga karrel, njesi kompjuterike, amplifikator EEG, stimulator optik, software per administrimin e te dhenave dhe per marrjen e sinjaleve cerebrale nga EEG

- **Karrel EEG**
 - Njesi e levizshme me rrota, e pajisur me transformator me izolim, me mbajtese vertikale ekrani dhe sirtar per pozicionimin e tastjeres dhe mouse.
 - Te perfshihet krah mbajtes per montimin e amplifikatorit EEG i cili mundeson pozicionimin ne afersi te pacientit.
 - Te perfshihen kabllot e nevojshme te fuqise per lidhjen me rrjetin AC 220V/50Hz
- **Njesia Kompjuterike**
 - Kompjuter me karakteristika minimalisht 3.0GHz CPU, 8Gb RAM, 256GB HDD, pajisur me porta USB dhe lexues/shkrues CD/DVD.
 - Ekran me dimensione minimale 21 inch.
 - Perfshihet tastjere alfanumerike dhe mouse.
 - Te perfshihet edhe printer laser A4 bardh/zi.
- **Amplifikatori EEG**
 - Amplifikator EEG me te pakten 32 kanale dhe mundesi per 64 kanale

- Verifikimi i impedences elektrike te lidhjes se elektrodave ne amplifikator
- Frekuenca e kampionimit deri ne te pakten 4 KHz/kanal ose me shume
- Impedenca elektrike ne hyrje te pakten 0.8 GΩ
- Amplituda e sinjaleve hyrese te pakten + 7mV
- Zhurma elektronike duhet te jete jo me shume se 0.5 μVolt
- CMRR duhet te jete te pakten 110 dB
- Shpejtesi gjurmimi min. 1-2000 mm/sek
- Rezolucioni deri 50 pV
- Konvertimi Analog/Dixhital i sinjaleve me te pakten 32 bit
- Filter per frekuencat e ulta min. deri 70Hz
- Filter per frekuencat e larta min. deri 500Hz
- Modul SpO2 i integruar
- Pajisur me sensor pozicionimi
- Mikrofon dhe altoparlant i integruar
- Karte memorie e brendshme min. 32GB
- **Stimulator Optik**
 - Teknologji e ndricimit LED
 - I sinkronizuar me sinjalet EEG dhe frekuence e rregullueshme nepermjet software deri ne 60Hz.
 - Programe manuale dhe automatike
- **Software**
 - Databaze me te dhenat e pacienteve, regjistrimet e formave valore te EEG dhe raportet mjekesore, rishikimi dhe analizimi
 - Mundesi i zgjedhjes se programeve te paracaktuara perfshire dhe simulimi me ndricues, te pakten 4
 - Analize spektri
 - Monitorim i funksionit cerebral
 - Monitorim neurologjik salle reanimacioni
 - Detektim ne kohe reale te kulmeve dhe krizave
 - Video full HD
 - Aftësi të plota polisomnografike
- **Aksesore:**
 - Set i plote me 40 elektroda EEG ne bridge, me konektore dhe kabell te integruar.
 - Te perfshihen dy elektroda tokezimi per lidhje aurikolare
 - Te jete pajisur me te pakten 2 kokore CAP te pershtatshme per elektrodas dhe me permasa te ndryshme per paciente adult.
 - Te perfshihen disa kontenitore 200-250g me paste adezive per fiksimin e elektrodave

7. Defibrilator

Zhvillues Filmash Mjekesore Analoge

- Defibrilator Bi-Fazik me Pacer per arrestet kardiake akute dhe kronike
- Me karikues dhe bateri.
- Peshë e lehtë (jo me shumë se 4.5 kg) dhe modeli i fundit
- Tensioni i hyrjes 220-240 VAC, 50/60 Hz;
- Menyrat e punës: Manuale, Pacer, AED dhe Monitorim
- Monitor LCD/TFT me ngjyra me rezolucion min. 1200x1010
- Madhësia jo me pak se 9" (touchscreen) me prekje.
- Shfaqje e min. 7 formave valore njekohesisht.
- Te kete kend shikimi te pakten 160° dhe mundesi ndricimi automatik.
- Zgjedhja manuale maksimale deri në 360 J.
- Diapazoni i energjise: min 1- 360 J
- Koha e karikimit me e vogel se 3 sekonda per energji 200J
- Koha e ndezjes se aparatit jo me shume se 3 sekonda.
- Koha e rikuperimit te EKG pas defrilimit: jo me shume se 2.5 sek
- Mundesi Monitorim te formave valore: EKG 12 lead, , HR, SPO2, CO2, NIBP, IBP, etj.
- Duhet te monitorohet EKG permes paddles, pads dhe elektrodave të monitorimit dhe Defibrilim permes pads dhe paddles.
- Te kete opsion per analizimin e EKG 12 kanale dhe mundesi krahasimi ne ekran te 2 raporteve EKG 12 kanale.
- Te kete te inkorporuar modalitetin e trajnimit CPR
- Duhet të ketë Defibrilim automatik dhe manual
- Menyrat e punës: Manuale, Pacer, AED dhe Monitorim.
- Te kete te instaluara funksionet per SpO2, NiBP, Temperature dhe mundesi shtimi per CO2 ; IBP dhe 12 lead EKG
- Duhet te kete regjistrues automatik dhe manual te integruar per printimin e informacionit të ruajtur të EKG-se.
- Pacing: min. 30 - 200ppm
- Saktësia: ±2%
- Rezolucion: 5 ppm
- Me tregues dixhital ne ekran te gjendjes se baterise.
- Te kete nje bateri qe mban jo me pak se 270 goditje 200J, ose 6 ore monitorim.
- Koha e karikimit te baterise: 3-4 ore.
- Treguesi i karikimit te jete ne ekran.
- Duhet te kete tregues, qe tregojne statusin e impedances së kontaktit midis pacientit dhe dorezave, si ne ekran ashtu edhe në dorezat e jashtme.
- Pajisur me printer termal me 6 kanale.
- Te jete me memorje te brendshme deri ne 100 ore forma valore te EKG.
- Nderfaqe: USB dhe LAN, Wi-Fi
- Rezistenca ndaj ujit e goditjeve: ≥ IP55 dhe rezistente nga renia ne jo me pak se 2m lartesi.

- Te kete mundesine te dergoje te dhena ne kohe reale ne Monitor Qendror.
- Te shoqerohet me aksesoret: Dorezat shumeperdorimshe Adulte/Pediatrike ,kabell ekg 10 lead, Sensor oksimetrie , Manshete monitorimi dhe 2 bateri.

Shenim : Te gjitha pajisjet duhet te shoqerohen me manualet e perdorimit ne Shqip ose Anglisht.

Argumentimi per specifikimet teknike : Keto specifikime jane vendosur ne baze te procesverablit date “per hartimin e domosdoshmerise dhe specifikimeve teknike “ nga Komisioni i hartimit te specifikimeve teknike si dhe ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“

FORMULARI I SASISE DHE GRAFIKU I LEVRIMIT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Destinacioni	Afati I dorezimit
1	Ekografi	cope	1	SRE	Sipas MK
2	EKG	cope	1	SRE	Sipas MK
3	Spirometer	cope	2	SRE	Sipas MK
4	Kabinet ORL	Komplet	1	SRE	Sipas MK
5	Kabinet Okulistik	Komplet	1	SRE	Sipas MK
6	EEG	cope	1	SRE	Sipas MK
7	Defibrilator	cope	1	SRE	Sipas MK

Afatet e levrimit : Njësia referuar relacionit të përlogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë :

Afati i Marrveshjes Kuader 6 (gjashte) muaj.

Sasia dhe Grafiku I levrimit : jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.*

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

30.10.2023 Ora: 10:00 www.app.gov.al

Per Lotin 2 F.V pajisje mobilimi spitalor per Polikliniken e Specialiteteve

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**;*
- b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojcës 2**;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 8**;*
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e percaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda dates 31 mars të vitit pasardhës**,

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akti Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, përma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje

të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **sa 20%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP nëni 40 pika 4: *“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	2
Punetore të thjeshtë	4
Marangoz	4
Saldator	2
Inxhinier Perpunimit të drurit	1
Arkitekt	1
Total	14

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontrate pune perkatese.
- Për punonjësit e punësuar marangoz të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin .
- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmitë e kualifikimit profesional teknik secilin.
- Për punonjësin e punësuar Inxhinier Perpunimit të Drurit të paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV për secilin,
- Për punonjësin e punësuar Arkitekt të paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV, Te gjithë punonjësit e kërkuar me lart duhet të jenë të deklaruar dhe të paraqitet listepagesat e sigurimeve shoqërore duke filluar nga muaji Janar 2023
- Operatori ekonomik të paraqes deklarate në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve
----	--------------	------------	----------------------------------

			punes
--	--	--	-------

Shenim: - Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushte me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

Kerkesa për numrin minimal të punonjësve është përcaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve të nevojshme, afatin e përcaktuar për lehtësimin e kontratave bazuar në MK, , e lidhur kjo me kohën e përfundimit të rikonstruksionit të godinës dhe venien e menjeherëshme të saj në funksionim.

Kerkesa për një Inxhinier Përpunimit të drurit është e lidhur ngushtesisht me realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 2 (dy) mjete transporti**, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Një mjet transporti me kapacitet mbajtës të pakten 1.5 Ton dhe të pajisur me Certifikatën e transportit të mallrave dhe një mjet transporti me kapacitet mbajtës të pakten 1 ton.

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Mjetet e transportit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

- Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarrres.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund te hartojë kritere ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktojë kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi/qira ose në përdorim të paktën **1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi**

- Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Ne rastin e paraqitjes te kontrates se qirase kontrata te jete e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertes deri ne realizimin e kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresen e autoritetit kontraktor, te perfshire ne kete procedure prokurimi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.7 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara te gjitha specifikimet teknike të kërkuara për artikujt. **Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar.** (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qellim vertetimin se operatori ekonomik i ploteson kerkesat minimale ne perputhje me nenin 40, pika 6 b) te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **ku shprehet rrjedhimisht:** 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

3 b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose ;

2.3.8 Ofertuesi duhet të paraqesë:

1- Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ”Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”,

(Certifikata të jetë leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për tregtim dhe/ose prodhim të mobiljeve, për artikujt e mobilimit të ofertuara.)

Shënim: Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, të paraqesë edhe Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente, për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuara, të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

2- Certifikatë ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente.

(Certifikata të jetë leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për tregtim dhe/ose prodhim të mobiljeve, për artikujt e mobilimit të ofertuara.)

Shënim: Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, të paraqesë edhe Certifikatë ISO 14001:2015 ose ekuivalente, për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuara, të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

Shënim: Çertifikata të jetë brenda afatit të vlefshmërisë, në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

3- Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente.

Shënim: Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, të paraqesë edhe Çertifikatë ISO 45001:2018 ose ekuivalente, për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuara, të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

Kriteri vendoset per rastin kur OE eshte prodhues vendor, si nje kerkese e shtuar per garantimin e zbatimit te kontrates ne cilesine dhe ne afatin e kerkuar nga AK.

Certifikatat per menaxhimin e sistemit te sigurise ne pune dhe menaxhimin e mjedisit nga keto OE, kane lidhje me kerkesat per zbatimin e standarteve, dhe jane vendosur ne perputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

2.3.9 Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë konformiteti CE për artikujt objekt prokurimi ose për lëndën e parë për prodhimin e tyre.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 3 dhe 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” (nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP Nr. 7998 Prot., datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbimi”.

2.3.10 Operatori ekonomik, ditën e hapjes së ofertave, për artikujt objekt prokurim, duhet të depozitojnë pranë Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Elbasan, mostrat si me poshte:

- Raft
- Paravento
- Dollap magazine
- Shtrat vizitash
- Poltron per marrje gjaku
- Shkalle pacienti
- Karrige rrotulluese

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e

çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

2.3.11 Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi dhe/ose lëndët e para të prodhimit të artikujve objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës sipas tabelës nr. 1.

- në rast se OE pjesmarrëse është tregtues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës
1		
2		
Etj.,		

- në rast se OE pjesmarrëse është përpunues i mallrave objekt prokurimi plotësojë të dhënat sipas tabelës nr. 2.

Tabela 2

Nr.	Emertimi i produktit (Lënda e parë)	Vendi i origjinës
1		
2		
Etj.,		

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standarteve apo certifikimeve CE/ ose ekuivalent - lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Specifikimet Teknike Loti 2- “F.V pajisje mobilimi spitalor per Polikliniken e Specialiteteve”

Shënim : Të gjitha fotot e paraqitura në këto specifikime kanë vetëm qëllim orientues.

1. Tavoline pune

Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 120 x 70 x 75 cm

Karakteristikat kryesore të produktit: Syprina melaminë me trashësi jo me pak se 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.




2. Tavoline pune forme L-je

Tavolinë pune forme L-je (gjatësi x gjerësi x gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 140 x 60 x 75 cm

Syprina Melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Sirtarjera përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën.

Elementë të tjerë shtesë: Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.



3. Raft me 2 kanata

Raft me 2 kanata (gjatësi x gjerësi x lartësi): 90 x 40 x 200 cm

Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 18 mm.

Kapakët janë me material PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 6 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali MFC, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllen me çelës dhe menteshat do të jenë me mbyllje me vakum . Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e hapur pa kanata e ndare ne 4 hapësira me anë të 3 sergjenave 25mm të cilët do të jenë gjithashtu me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej inoksi.



4. Raft me 2 kanata

Raft me 2 kanata (gjatësi x gjerësi x lartësi): 70 x 40 x 200 cm

Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 18 mm.

Kapakët janë me material PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 6 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali MFC, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllen me çelës dhe menteshat do të jenë me mbyllje me vakum . Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e hapur pa kanata e ndare ne 4 hapësira me anë të 3 sergjenave 25mm të cilët do të jenë gjithashtu me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej inoksi.



5. Shkalle pacienti

Shkalle dyshe per te ndihmuar pacientin te arrije ne shtration e egzaminimit ose Pajisjet diagnostikuese. Material metalik ose druri .

Gjeresia 48 – 50 cm

Gjatesia 35- 38 cm

Lartesia 43 – 47 cm



6. Shtrat vizitash

Shtrat egzaminimi pacienti i krijuar posaçërisht për pacientët te cilet I nenshtrohen egzaminimit te mjekut ,egzaminimeve imazherike në spital që kanë nevojë për një formë të kujdesit shëndetësor.

Shtrati të jetë i ndarë në dy pjesë: pjesa e kokes e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione.

Trashësia e dyshekut	4 – 6 cm
Gjatesia	187-195 cm
Gjeresia	60-70 cm
Lartesia	68-75 cm
Gjatesia e shpinores	57-60 cm
Kendi i rregullimit te shpinores	0-60°(±10%)
Me leve mekanike per rregullimin e shpinores	
Gjatesia e pjeses se trupit	130 - 135 cm
Fundet e kembeve me mbulese kunder rreshqitjes,	



7. Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krahë mbështetës plastik

Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike.

Karrigia do të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Do të paktohen në mënyrë të tillë që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.



8. Karrige statike

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësën. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me boje elektrostetike. Tapiceria të jetë textile .

Karrigia do të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Do të paktohen në mënyrë të tillë që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

9. Varesë rrobash (Prift për rrobat)

Material struktural metalik e rende, numri i ganxhave 6(gjashtë) ose 8(tetë), Përmasa - jo më e vogël se 175 cm h dhe diametër 42mm.



10. Karrige pritje 3 poste

Përmasat e produktit: stol 3 vendesh Min 178x66x78cm Max 183x70x83cm, Materiali: Inoks. Ngjyra: Do të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Kapaciteti i mbajtës 325-350 kg. Pjesë të qëndrueshme me lidhje të salduara, gjithë që rrit jetën dhe stabilitetin e karriges.



11. Poltrona për marrje gjaku

Mundesitë rregullimi manuale të mbështetëses së kokës dhe këmbëve

Mbështetëse për krahët me mbulesë vinili

Mbulesë e karrges vinili që pastrohet lehtë

Stativ IV teleskopik i lëvizshëm

Gjeresi 85 -89 cm

Gjatesi 100-115 cm

Lartësi 52 -55 cm



12. Paravento

Paravento për ndryesë amjenti në pavione .


Me tre seksione me perde të bardha ose blu.

Minimumi dy rrota për lëvizshmëri

Gjeresia 45 – 48 cm


Lartësia 173 – 180 cm

Struktura do të jetë metalike e lyer me bojë epokside e cila në pjesën fundore të saj do të ketë rrota rrotulluese për zvendosje , e veshur me beze antibakteriale .



13. Tavoline drejtorie

Tavolinë pune në formë T-je (gjatësi x gjërësi x gjatësi x gjërësi x lartësi) : 290 x 90 x 75 cm. Syprina material MFC me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës në forme diagonal me planin e punës në zgjatimin e takimeve. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi I planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që I jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapsirë 40cm, nga plani I dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e e lementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastic në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Sirtarjera të përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë I njëjtë me tavolinën.



14. Garderobe

Garderobe me 4 kanata (gjatësi x gjerësi x lartësi): 90 x 45 x 200 cm

Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 25 mm. Kapakët janë me material PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 6 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali MFC, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllen me çelës dhe menteshat do të jenë me mbyllje me vakum . Dollapi brenda këtyre kapakëve do jetë i ndarë në 5 pjesë me anë të sergjenave me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej inoksi.



Argumentimi per specifikimet teknike : Keto specifikime jane vendosur ne baze te procesverablit date “per hartimin e domosdoshmerise dhe specifikimeve teknike “ nga Komisioni i hartimit te specifikimeve teknike si dhe ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“

FORMULARI I SASISE DHE GRAFIKU I LEVRIMIT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Destinacioni	Afati I dorezimit
1	Tavoline pune + 2 sirtare	cope	2	SRE	Sipas MK
2	Tavoline L	cope	40	SRE	Sipas MK
3	Raft 90x40x200 cm	cope	40	SRE	Sipas MK
4	Raft 70x40x200 cm	cope	11	SRE	Sipas MK
5	Shkalle pacienti	cope	40	SRE	Sipas MK
6	Shtrat vizitash	cope	40	SRE	Sipas MK
7	Karrike rrotulluese	cope	40	SRE	Sipas MK
8	Karrike statike	cope	100	SRE	Sipas MK
9	Prift per rrobat	cope	40	SRE	Sipas MK
10	Karrike pritje 3 poste	cope	16	SRE	Sipas MK
11	Poltrona per marje gjaku	cope	2	SRE	Sipas MK
12	Paraventa (ndarese ambienti)	cope	40	SRE	Sipas MK
13	Tavoline drejtorie	cope	1	SRE	Sipas MK
14	Garderobe	cope	15	SRE	Sipas MK

Afatet e levrimit : Njësia referuar relacionit të përlogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë :

Afati i Marrveshjes Kuader 6 (gjashtë) muaj.

Sasia dhe Grafiku I levrimit : jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.*

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
30.10.2023 Ora: 10:00 www.app.gov.al